REPUBLIKA E KOSOVËS★REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit ★ Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Administratës
Direktorijat za Administraciju
Yönetim Müdürlüğü
DALËSE-IZLAZ-ÇIKIŞ
001-011 Nr. 33941 Dt. 12.03.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Kuvendi i Komunës**
**Nr. 001/011 - 33941**
**Më: 06 mars 2024**

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja d), dhe nenit 40, paragrafi 1 dhe 2, shkronja l), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25, paragrafi 1, shkronja o), dhe nenit 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643 të datës 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më 06 mars 2024, miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA 2024-2027

## Neni 1

Miratohet Strategjia komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

## Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive Komunale, si dhe subjektet tjera të përfshira për zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit.

## Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi, pasi të plotësohen kushtet e parapara sipas nenit 81, të LVL-së dhe do të shpallet në ueb faqen e komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit**
**Antigona Bytyqi**

Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Kosova Cumhuriyeti

Prizren Belediyesi

Republika Kosovo

Opština Prizren

# Projekt-Strategjia komunale dhe plani iveprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024 – 2027

Prizren, 2024



Të nderuar qytetarë të Komunës së Prizrenit

”Strategjia komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027” është edhe një kontribut i jonë i radhës, përmes së cilit dëshirojmë që ta konfirmojmë vullnetin tonë politik dhe përkushtimin institucional të komunës së Prizrenit, për të bërë ndryshime pozitive me synim sigurimin e shërbimeve kualitative për të gjithë qytetarët e saj pa dallim përkatësie etnike, fetare, politike dhe statusi social.

Personat me aftësi të kufizuara janë një nga grupet sociale më të prekura nga shumë probleme, por më sfidues vazhdon të mbetet varfëria dhe pasojat e saja socio-ekonomike.

Përqasja në mes të varfërisë, pa-aftësisë dhe përjashtimit social ndikon drejtpërdrejt tek personat me aftësi të kufizuara, sidomos në një shoqëri me tregues të ndjeshëm të varfërisë.

Andaj, duke synuar vazhdimisht që të bëhen ndryshime pozitive institucionale, Komuna e Prizrenit vazhdon fuqizimin e kapaciteteve të saja vepruese përmes hartimit të këtij dokumenti strategjik për shërbimet, situatën, dhe fushat e ndërhyrjes për periudhën katër vjeçare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky dokument strategjik do të shërbejë edhe për promovimin e të drejtave, dinjitetin dhe mirëqenien e kësaj kategorie të qytetarëve në shoqëri. Personat me aftësi të kufizuara duhet të integrohen në të gjitha segmentet e shoqërisë, si në atë ekonomik, politik, shoqërorë dhe kulturorë, dhe pikërisht përmes këtij dokumenti strategjik komuna e Prizrenit përpiqet që të dizajnojë mënyra, për të ndërhyrë në zgjidhjen e qëndrueshme të sfidave të cilat hasen sot në procesin e plotë integrues të PAK në shoqërinë kosovare.

Sigurimi i një mbështetjeje të plotë institucionale dhe pjesëmarrja aktive e personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore dhe në zhvillim, promovimi dhe avancimi i të drejtave të tyre, mbrojtja e dinjitetit, dhe mbështetja për të pasur qasje të barabartë në punësim, arsimim, dhe shërbime janë dhe do të mbeten prioritet i punës së komunës së Prizrenit.
Veprimet e propozuara në këtë dokument strategjik të komunës së Prizrenit, shprehin qartë se çfarë duhet të ndërmerret me qëllim të përmbushjes së këtyre pritjeve të cilat burojnë nga ky dokument.

Me këtë rast dëshiroj që personalisht t'i inkurajoj institucionet e qeverisjes komunale të komunës së Prizrenit, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit, komunitetet etnike dhe komunitetin ndërkombëtar që t'i bashkëngjiten kësaj nisme të zbatimit të këtij dokumenti strategjik dhe që të punojmë të gjithë së bashku, duke e shprehur gatishmërinë time të pa rezervë për të arritur që të ndërtojmë një qeverisje lokale e cila është në shërbim të qytetarit.

Le të jetë kjo ftesa ime për të gjithë për t'u përfshirë në këtë ndërmarrje të rëndësishme për qytetarët tanë dhe të gjithë së bashku të vlerësohemi mbi baza të arritjeve tona.

Sinqerisht,

ShaqirTotaj

Kryetar i Komunës së Prizrenit

## Falënderimet

Hartimi "Strategjia komunale dhe plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2024-2027" ishte një përpjekje nga asambleistjaznj. EgzonaHoxhaj në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit dhe organizatën ‘’DownSyndrome Kosova’’.

Për këtë arsye Komuna e Prizrenit shpreh mirënjohjen e thellë ndaj të gjitha palëve të përfshira në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik dhe të planit të tij të veprimit, në veçanti ndaj organizatës ‘’DownSyndrome Kosova’’, të cilët dhanë kontribut të çmueshëm dhe mundësuan edhe realizimin e hartimit të këtij dokumenti.

Falënderim për përfaqësuesit e drejtorive të caktuara, shërbimet e të cilave lidhen drejtpërdrejtë me mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara për konstruktivitetin dhe kontributin e dhënë në procesin e hartimit të strategjisë komunale dhe të planit të veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2024-2027, pa ekspertizën dhe përkushtimin e të cilëve hartimi i dokumentit do të ishte i vështirë.

## Shkurtesat

| | |
|---|---|
| AK | Asambleja Komunale, |
| AMF | Ambulanca e Mjekësisë Familjare, |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit, |
| DA | Drejtoria e Administratës, |
| DBF | Drejtoria për Buxhet dhe Financa, |
| DKRS | Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, |
| DShP | Drejtoria e Shërbimeve Publike, |
| DSh | Drejtoria e Shëndetësisë, |
| DUHP | Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, |
| DPMS | Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, |
| FNV | Fëmijët me Nevoja të Veçanta, |
| GP | Grupi Punues, |
| IAL | Institucionet e Arsimit të Lartë, |
| KK | Kuvendi i Komunës, |

| | |
|---|---|
| PAK | Personat me Aftësi të Kufizuara, |
| RrKG | Rrjeti Kosovar i Gruas, |
| QMS | Qendra e Mirëqenies Sociale, |
| QKMF | Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare, |
| OShC | Organizatat e Shoqërisë Civile, |
| SKPAK | Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara, |
| ZBGj | Zyra për Barazi Gjinore, |
| ZDNj | Zyra për të Drejta të Njeriut, |
| ZL | Zyra Ligjore, |
| ZIE | Zyra për Integrime Evropiane, |
| ZK | Zyra e Kryetarit. |

## HYRJE

Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), janë një numër  i konsiderueshëm i qytetarëve në Komunën e Prizrenit. Pavarësisht aftësive të tyre ata kanë të drejta dhe nevoja për të cilat shoqëria, shteti dhe posaçërisht qeverisja lokale duhet që t'i përmbushin konform konventave dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Vetëm duke i zbatuar në plotni të gjitha këto obligime institucionale, personat me aftësi të kufizuara do të ndjehen të vlerësuar, të barabartë dhe jo të diskriminuar në raport me qytetarët e tjerë.

Pikërisht strategjia komunale për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prizrenit, është hartuar në përputhje dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 - 2023 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 - 2015,dhe gjithsesi duke i konsultuar të gjitha dokumentet tjera vendore dhe ndërkombëtare, të cilat e rregullojnë çështjen e personave me aftësi të kufizuar.

Qëllimi i SKPAK është gjithëpërfshirja, eliminimi i barrierave ekzistuese dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes gëzimit të të drejtave bazë në punësim-formim profesional, arsimim, shërbime shoqërore dhe përshtatshmëri në komunën e Prizrenit.

Struktura e SKPAK është e organizuar në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet kontekstin në të cilin është hartuar SKPAK si edhe procesin i cili ka shoqëruar formulimin e kësaj strategjie, kuadrin ligjorë, nocione bazë dhe të dhëna të përgjithshme.

Pjesa e dytë është një analizë cilësore në fushën e shërbimit shoqëror, arsimit, punësimit e formimit profesional dhe përshtatshmërisë së ambienteve.

Pjesa e tretë përmban ndërhyrjet strategjike në secilën nga fushat për periudhën kohore 2023-2027, për përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara në komunën e Prizrenit.

### Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar

Para se të vazhdohet më tej, konsiderohet të shpjegohet terminologjia e personave me aftësi të kufizuar, në mënyrë që të gjitha palët e interesit të kuptojnë njëjtë terminologjinë e përdorur.

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi "person me handikap" është zëvendësuar me termin "Person me Aftësi të Kufizuara" (individualisht) dhe "Personat me Aftësi të Kufizuara" (në nivel shoqëror).

Që tani e tutje Personat me Aftësi të Kufizuara janë ata persona tek të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.

Ky përcaktim, i cili i përmbahet propozimit të OBSH, nuk bazohet në mungesa reale apo të supozuara. Në qendër të vëmendjes vendoset pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Një ndryshim nga kushtet normale do të thotë humbje ose kufizime në lidhje me strukturat fizike, mendore apo psikologjike, të cilat janë të pranishme në moshën përkatëse. Aftësia e Kufizuar ekziston në rast se dëmtimi çon në një kufizim, i cili ndikon në pjesëmarrjen në një ose disa fusha të jetës. Kriteri i zgjatjes prej gjashtë muajsh të kufizimit përjashton parregullsitë e përkohshme, të cilat nuk konsiderohen si aftësi e kufizuar, por nuk përjashton ndërhyrjet e menjëhershme që janë të nevojshme në rastet individuale për shmangien e saj. Kjo ka të bëjë në veçanti me fëmijët, tek të cilët është verifikuar aftësia e kufizuar apo rreziku i mundshëm i aftësisë së kufizuar.

**Parimet themelore**

Ky dokument strategjik, për të gjitha palët e interesit, si ato të organizatave të shoqërisë civile, ashtu edhe nga institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, duhet të udhëhiqet nga parimet e përgjithshme tësë drejtës për të qenë pjesë e shoqërisë kosovare. Janë gjithsej shtatë parime në bazë të së cilave është hartuar dokumenti strategjik për PAK për rajonin e Prizrenit.

**Parimi i së drejtës shoqërore, barazisë dhe mosdiskriminimit**

Personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Kjo përfshin ndihmën sociale që i lejon personat me aftësi të kufizuara të jetojnë me dinjitet.

**Parimi i vetëvendosjes**

Vjen nga përqasja me të drejtën shoqërore dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara, duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë të aftë të vendosin vet. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale. Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me rehabilitimin, duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuar. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë pa pëlqimin e tij/saj.

**Parimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta**

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë ku ata jetojnë, prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit e tjerë. Ata kanë përfitime që i lejojnë ata të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

**Parimi i jetesës pa barriera dhe mjedisit të lirë**

Ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen pa pengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuar pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

**Parimet e parandalimit, identifikimit dhe trajtimit të hershëm**

Ka të bëjë me një numër masash që ndërmerren për të evituar sa të jetë e mundur shfaqjen e aftësisë së kufizuar dhe sëmundjeve kronike, në të gjitha grup-moshat dhe në të gjitha fushat e jetës. Në këtë aspekt fushat me rëndësi janë mbrojtja e shëndetit, siguria në punë, parandalimi i aksidenteve dhe mbrojtja e mjedisit. Ky parim gjithashtu përfshin parandalimin e aftësisë së kufizuar përgjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet masave siç janë imunizimi etj. Kjo reflekton intuitën që sa më herët të identifikohet në fëmijëri një parregullsi, aq më i mirë dhe i shpejtë do të jetë parandalimi i aftësisë së kufizuar ose trajtimi i suksesshëm i saj. Kjo vlen për të gjitha grup-moshat.

**Parimi i rehabilitimit**

Qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, mënjanimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit të saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuara.

**Parimi i qëllimshmërisë**

Parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar dhe personave që kanë rrezik të bëhen të tillë, pavarësisht nga shkaku i aftësisë së tyre të kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

**Metodologjia e hartimit të dokumenteve strategjike**

Hartimi i Strategjisë  Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prizrenit ka filluar në maj të vitit 2023, me përkrahjen e komunës së Prizrenit dhe ''DownSindrome Kosova''. Fillimisht janë organizuar mbi IO punëtori me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, ku janë identifikuar fushat problemore që duhen adresuar me strategji. Çdo njërës fushë problemore i është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e problemeve duke e përdorur instrumentin  e analizës SËOT. Më pas fushave problemore u janë përcaktuar masat dhe veprimet konkrete të ndara sipas përgjegjësive institucionale, si dhe mundësitë ku organizatat e shoqërisë civile mund ta japin kontributin e tyre, në zbatimin e këtyre dokumenteve strategjike komunale.

Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prizrenit bazohet në Kushtetutën e Republikën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 - 2023, dhe  Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 - 2015, Statutin e Komunës së Prizrenit, si dhe konventën ndërkombëtare për drejtat dhe liritë e njeriut.

Në këto dokumente strategjike janë përfshirë pesë fusha problemore të cilat duhen trajtuar nga institucionet e qeverisjes lokale. Po ashtu plani i veprimit për Komunën e Prizrenit përPAK bazohet në këto pesë fusha, të cilat veç e veç janë trajtuar në detaje, ku për secilën fushë janë identifikuar masat përkatëse, aktivitetet konkrete, treguesit, institucionet dhe personat përgjegjës për ndërmarrjen e atyre aktiviteteve, përkrahësit si dhe është reflektuar buxheti që është i paraparë nga përgjegjësit dhe përkrahësit, gjegjësisht nga organet lokale të qeverisjes, nga donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Për hartimin strategjisë dhe të planit të veprimit përPAKnë komunën e Prizrenit është formuar një grup i punës, i përbërë nga përfaqësues të komunës dhe asamblistë komunalë, nga organizatat e shoqërisë civile, organizatave jo-qeveritare dhe ekspert të fushave përkatëse, si dhe organeve gjegjëse komunale siç është ZBGj, ZL dhe ZIE. Përveç kësaj, janë konsultuar edhe përfaqësues të komunave të tjera të Republikës së Kosovës,për të marrë praktikat e mira ashtu që kjo strategji dhe ky plan i veprimit të jetë i përdorshëm, i zbatueshëm dhe funksional.

Tryezat dhe punëtoritë gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit, për përfshirjen e sa më shumë palëve nga qeverisja lokale dhe komuniteti i organizatave jo-qeveritare. Kjo qasje ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë.

Metodologjia e përdorur në procesin e hartimit të strategjisë dhe të planit të veprimit është përmes planifikimit me pjesëmarrje të gjerë, gjegjësisht përmes metodologjisë së kornizës logjike dhe veglave të saja të planifikimit, si analiza SËOT.

Ky grup punës ka analizuar rezultatet e të gjitha punëtorive paraprake duke i definuar në mënyrë eksplicite sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që lidhen me sfidat e informimit në kohë dhe të pa-anshëm, komunikimit efektiv me publikun dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim marrëse dhe aktivitetet tjera të komunës me interes të përgjithshëm në komunën e Prizrenit, në fushat e trajtuara me strategji dhe plan veprimi.

Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit ka ndjekur qasjen pjesëmarrëse dhe qasjen e bazuar në të drejta, duke i ndjekur direktivat vijuese:

1. Strategjia është hartuar me një qasje pjesëmarrëse të gjerë, duke përfshirë përfaqësues të organeve komunale relevante, organizatave të shoqërisë civile, dhe të mediave.
2. Organizatat e shoqërisë civile dhe të mediave përfshihen në zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit.
3. Hartimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit shihet në kontekst më të gjerë; nismat tjera të komunës dhe të institucioneve ndërkombëtare janë pika të referimit.
4. Strategjia dhe plani i veprimit nuk synon të zëvendësojë por të plotësojë nismat e përgjithshme. Rrjedhimisht, strategjia dhe plani i veprimit ndjek një qasje kryesore sa herë që kjo është e mundur, e plotësuar me veprime afirmative sa herë që kjo është e nevojshme.
5. Rekomandimet të cilat burojnë nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Këshillit të Evropës si dhe rekomandimet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian janë direktiva të rëndësishme, për hartimin dhe zbatimin e këtij plani të veprimit.
6. Zbatimi i sinqertë dhe realist i strategjisë i bazuar në burimet e identifikuara financiare, është kyç për përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara. Përfshirja e zbatimit të strategjisë si prioritet është garanci për zbatimin e sinqertë dhe realist.
7. Komuna e Prizrenit do të themelojë një mekanizëm përgjegjës për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për persona me aftësi të kufizuara.

## Zbatimi i dokumentit nga institucionet e qeverisjes lokale

Masat dhe veprimet e përshkruara në këtë dokument strategjik duhen të zbatohen në të gjitha politikat dhe projektet, duke vënë në plan të parë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara.

Rritja e përfshirjes shoqërore të personave me aftësi të kufizuara, do të zhvillohet paralelisht me procesin e ndërgjegjësimit të shoqërisë, gjë që do të rezultojë në përfshirjen e saj në këtë proces.

Përmes zyrës komunale për të drejta e njeriut – në kuadër të së cilës do të jetë edhe zyrtari për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, i cili do të jetë përgjegjës në lidhje më çështjet të cilat kanë të bëjnë me persona me aftësi të kufizuara, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet krijimit të një strukture efektive monitorimi dhe raportimi, e cila do t'u mundësojë të gjitha palëve të përfshira në proces, duke futur këtu edhe donatorët ndërkombëtarë, të matin progresin në zbatimin e këtij dokumenti, por edhe ndikimin të cilin e ka pasur zbatimi i një dokumenti të tillë në përmirësimin e gjendjes dhe të standardit jetësor të PAK në komunën e Prizrenit.

## Sfidat

Analiza e politikave aktuale në fushën e aftësisë së kufizuar nxjerr në pah dy sfida kryesore:

- Përmirësimin e politikave koherente, të cilat duhet të harmonizohen me standardet dhe praktikat ndërkombëtare,
- Zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Është e vetëkuptueshme se realizimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara, në jetën shoqërore ka nevojë për një proces afatgjatë dhe shumë-dimensional, suksesi i të cilit varet në masë të madhe nga përpjekjet e administratës dhe të shoqërisë civile në komunën e Prizrenit.

Institucionet komunale duhen të shprehin vullnetin dhe angazhimin e plotë për të punuar në vazhdimësi përkundrejt dy sfidave kryesore të përmendura më lart, duke shprehur njëkohësisht gatishmërinë për të shfrytëzuar përvojën dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile.

Institucionet komunale, si objektiv themelor të të gjitha politikave duhet të kenë përmirësimin e konsiderueshëm të kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara, përmes arritjes së rezultateve afatgjata dhe të qëndrueshme në përfshirjen e tyre në shoqëri si qytetarë që ushtrojnë të drejtën e mundësive të barabarta, dhe që gëzojnë të drejtat e plota shoqërore dhe njerëzore.

Vizioni dhe misioni i strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuar

Vizioni i këtij dokumenti strategjik është që t'i kontribuojë institucioneve komunale për tu shndërruar në një qeverisje komunale gjithëpërfshirëse dhe e mundësive të barabarta, e gatshme për ti përmbushur nevojat e personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të përshtaten sa më mirë në të, duke e njohur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të qenë të ndryshëm dhe për të jetuar jetën e tyre në atë mënyrë që i plotëson nevojat e tyre të veçanta pa paragjykime.

Misioni i dokumentit strategjik, gjegjësisht obligimi që komuna merr përsipër për Personat me Aftësi të Kufizuara,është që të përmirësohet jeta e tyre në komunën e Prizrenit. Komuna e Prizrenit, përmes realizimit të këtij dokumenti strategjik, ndërmerr veprime të cilat çojnë drejt një shoqërie ku personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e një bote pa barriera, ku çdokush ka mundësinë për të bërë zgjedhje për ta përmirësuar jetën e vet dhe për të quar një jetë të pavarur dhe me dinjitet.

**Objektiva e parë e strategjisë komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara**

Me këtë objektiv është synuar që të lehtësohen në njërën anë, dhe në anën tjetër të përmirësohen shërbimet shëndetësore për PAKnë komunën e Prizrenit. Për ta mundësuar arritjen e këtij synimi të institucioneve komunale, janë planifikuar të ndërmerren një sërë masash dhe veprimesh, të cilat përkojnë me detyrat dhe përgjegjësitë e nivelit lokal të qeverisjes.

Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, është masë e planifikuar me kujdes, e cila do të çoj në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për PAK. Fillimisht do të zbatohet një analizë e gjendjes shëndetësore dhe nevojave për kujdes shëndetësor për PAK në komunën e Prizrenit. Të gjeturat nga kjo analizë e gjendjes do ta determinojnë nevojën për intervenim në përmirësimin e kapaciteteve të personelit shëndetësor, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për PAK. Do të organizohen trajnime të strukturuara për ekipet mjekësore dhe infermierët që ofrojnë shërbime shëndetësore specifike për PAK.

Ngritja e kapaciteteve të kuadrit mjekësor për zbulimin e hershëm të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar, ngritja e mëtutjeshme profesionale e personelit mjekësor në fushën spinale dhe rehabilituese, përfshirë infermieret, janë veprime të cilat pritet

që të ndikojnë pozitivisht në identifikimin e hershëm të shkallës së aftësisë së kufizuar, por edhe të trajtimit adekuat në zbutjen e aftësisë së kufizuar. Në mënyrë që komuna Prizrenit të posedojë informata të detajuara mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara, do të ndërtohet një bazë e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara. Kjo bazë e të dhënave do të shërbejë për nevojat e institucioneve komunale dhe e njëjta do të përditësohet vazhdimisht. Sigurimi i qasjes në gjuhën e shenjave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimi i shërbimeve emergjente për personat e shurdhër, po ashtu do të jetë një kontribut i rëndësishëm i komunës karshi ofrimit të shërbimeve kualitative për PAK.
Sigurimi i mjeteve të nevojshme përPAK duke e vënë prioritet furnizimin me barna dhe materiale shpenzuese dhe sigurimi i materialit për inkontinencë si dhe materialit për plagë dekubitare, do të jetë një obligim institucional i cili do t'i kontribuojë përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për PAK.

Rol të rëndësishëm në çështjen e aftësisë së kufizuar padyshim që luanë ndërgjegjësimi i komunitetit në fushën e PAK. Hartimi i programit për edukim shëndetësor dhe i pakos informuese për prindër në zbulimin e hershëm të shkaktarëve, që rezultojnë në aftësi të kufizuar dhe zbatimi i programit për edukim shëndetësore, për prindër, për të ndikuar në zbulimin e hershëm të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar, llogariten si veprime të domosdoshme institucionale të cilat ndihmojnë në identifikimin e hershme të aftësisë së kufizuar dhe parandalimin e përhapjes së mëtejme të tij. Vetëdijesimi për vaksinim me kohë të fëmijëve e ndihmon pikërisht këtë përpjekje parandalimi të përhapjes së aftësisë së kufizuar.

Mbasi që kemi të bëjmë me një kategori të ndjeshme të shoqërisë dhe kufizimeve në mobilitetin e tyre, planifikohen veprime të ofrimit të shërbimeve mobile të komunës, e cila paraprakisht do të caktoj punëtorët shëndetësorë nga mjekësia familjare dhe do ti Identifikoj lagjet ndërurbane, urbane dhe rurale për vizita. Do të hartohet një kalendar për vizita sistematike mobile për PAK, të cilat veç tjerash do të kryejnë vaksinimin periodike dhe PAK do t'u ofrojnë librezat e imunizimit.

Ofrimi i këshillimeve profesionale për PAK në kuadër të këshillimores ekzistuese, ku do të delegohet personeli mjekësor i trajnuar për personat me aftësi të kufizuar, do të jetë një veprim i radhës i cili do t'i kontribuojë përmirësimit të shërbimeve të përgjithshme shëndetësore për PAK.

Lehtësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore për PAK do t'i kontribuojë ndërtimi i një sistemi elektronik i dosjeve shëndetësore, me të dhëna të përditësuara dhe shkëmbimi i të dhënave me qendrat tjera shëndetësore / AMF-të. Lehtësim shtesë i tërë këtij veprimi institucional do të jetë lirimi i përkohshëm nga participimi në shërbimet e mjekësisë familjare, për të gjithë individët nga radhët e PAK.

**Objektiva e dytë ”Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të PAK”**

Gjithëpërfshirja në arsim dhe mbështetja profesionale për personat me aftësi të kufizuara është nevojë jetike, e cila drejtpërsëdrejti ndikon jetën e personave me aftësi të kufizuara dhe të ardhmen e tyre. Për të bërë ndryshime substanciale të kësaj gjendje për personat me aftësi të kufizuara, strategjia parasheh që të ndërmerren një sërë masash dhe veprimesh institucionale. Hartimi i politikave për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në arsim, sipas parimeve të gjithëpërfshirjes do të jetë një veprim i domosdoshëm të cilit do ti paraprijë një hulumtim i përgjithshëm, për situatën e personave me aftësi të kufizuara në arsim, në komunën e Prizrenit.

Marrjes së kompetencave në nivel komunal për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, do ti paraprijë emërimi i një koordinatori të arsimit gjithëpërfshirës, profesionalist për personat me aftësi të kufizuara në DKA duke u pasuar ngritja e kapaciteteve të autoriteteve komunale të arsimit për menaxhimin e arsimit të qasjes me FNV.

Themelimi (krijimi) i një sistemi (mekanizmit) mbështetës për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara është një masë mirë e planifikuar, e cila do të pasohet nga emërimi dhe funksionalizimi i ekipit për vlerësim në komunë, angazhimi i mësuesve udhëtues, adaptimi i programeve për ofrimin e edukimit në shtëpi dhe gjatë trajtimit shëndetësor, angazhimi i mësimdhënësve mbështetës dhe përgatitja e një udhëzuesi për funksionimin e ekipeve vlerësuese dhe të koordinatorit të arsimit gjithëpërfshirës.

Ngritja e vetëdijes së shoqërisë mbi arsimin gjithëpërfshirës për FNV, është njëra ndër masat më të duhura e cila do ta instalojë një kulturë të përgjithshme të trajtimit të barabartë të FNV dhe fëmijëve të tjerë. Zbatimin e kësaj mase do ta përcjellin veprimet institucionale sikurse që janë: Organizimi i fushatave të vetëdijesimit, spote në radio/tv, shkrimet në gazeta, kampet verore, aktivitetet sportive, debatet, tryezat e rrumbullakëta, aktivitetet verore, shënimi i datave ndërkombëtare për promovimin e të drejtave të FNV, prodhimi dhe shpërndarja e materialeve për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës etj.

Krijimi i mekanizmave ndër-sektoriale në nivel komunal, për identifikim dhe intervenim të hershëm është masë e radhës e planifikuar me këtë dokument strategjik, e cila do të mundësohet duke u mbështetur në veprimet institucionale sikurse që janë: zhvillimi dhe zbatimi i programeve specifike për intervenim të hershëm, bërja e analizës për gjendje aktuale tek FNV, krijimi i bazës së të dhënave për identifikim dhe intervenim të hershëm përfshirë grup moshën 3-5, zhvillimi i fushatave vetëdijesuese për identifikimin dhe intervenimin e hershëm, organizimi i trajnimeve për drejtues të shkollave dhe stafit edukativ për identifikim dhe intervenim të hershëm, trajnimet për prindër për identifikim dhe intervenim të hershëm, si dhe formimi i forumit të mësuesve për arsim gjithëpërfshirës.

Me qëllim të përmirësimit të qasjes së personave me aftësi të kufizuara në arsim, strategjia parasheh një varg veprimesh institucionale të domosdoshme për ti ndërmarrë sikurse që janë: organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për fëmijë dhe familje lidhur me rëndësinë e arsimimit, organizimi i aktiviteteve/ lojërave të vazhdueshme me fëmijë të moshës së hershme, organizimi i vizitave të fëmijëve në institucionet parashkollore dhe shkollore, organizimi i orëve plotësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara, ofrimin e materialeve didaktike dhe lojëra për nxënësit nevojtarë, organizimet nga shkollat takime të rregullta grupore dhe individuale me

familjarë që kanë fëmijë më aftësi të kufizuar, ofrimin e bursave për nxënësit nga radhët e personave me aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta, dhe adaptimin e programeve për integrimin e nxënësve që nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë apo që kanë braktisur shkollën (mësim përshpejtues).

Gjithëpërfshirja e personave me aftësi të kufizuara është masë e cila i kontribuon dukshëm komponentësh së arsimit të personave me aftësi të kufizuara dhe e cila do të zbatohet përmes sigurimit të transportit në shkollë, për fëmijët me nevoja të veçanta. Në mënyrë që gjithëpërfshirja të jetë kuptuar drejtë, komuniteti arsimor dhe ai i nxënësve do të njoftohen për konceptin gjithëpërfshirës, do të organizohen aktivitete nga shkollat në komunitet që ta promovojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen.

Edukimi joformal për familjarët në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara është identifikuar si masë e duhur në mënyrë që të krijohet një ambient miqësor dhe përkrahës për personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të arrihet fillimisht duke Identifikuar nevojat për edukimin joformal dhe më pas organizimin e seancave të rregullta të edukimit joformal.

Arritja e një marrëveshjeje me shkollën e mesme të mjekësisë për kryerje të praktikës nga nxënësit në shkollat fillore të ciklit të ulët ku ka FNV do të kontribuonte në krijimin e ambientit miqësor dhe përkrahës për FNV.

Në mënyrë që të sigurohet një mbikëqyrje cilësore, monitorim dhe vlerësim i rregullt për praktikat e gjithë përfshirjes, do të ndërtohen kapacitete institucionale përmes hartimit dhe zbatimit të një rregulloreje për gjithëpërfshirës. Raportimi i rregullt do të jetë instrument i duhur përmes të cilit do të ndahen informatat me palët e interesuara mbi zbatueshmërinë e praktikave gjithëpërfshirës ërFNV.

**Objektiva e tretë "Ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e PAK dhe rritje të mirëqenies"**

Është po ashtu një rezultat i synuar dhe mirë planifikuar në këtë dokument strategjik, i cili për t'u realizuar do të tërheq mbas një grumbull masash dhe veprimesh të duhura institucionale.

Krijimi i kushteve të barabarta për punësimin e PAK si masë e identifikuar për përmbushjen e kësaj objektive do të mundësohet duke organizuar fushata vetëdijesuese për punësimin e PAK në sektorin privat; vendosjen e paneleve informuese për punësim në vendet më të dukshme të qytetit; identifikimit e të gjitha shërbimeve profesionale që i kryejnë pjesëtarët e PAK dhe postimin e tyre.

Aftësimi dhe riaftësimi profesional për punësimin e PAK si masë e radhës e cila do ti kontribuojë arritjes së kësaj objektive, do të mundësohet duke i zgjeruar profilet për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave së tregut të punës, si dhe hartimin e

programeve për punësim të PAK. Do të hartohen programe të reja të aftësimit profesional për PAK duke marrë parasysh potencialin ekonomik në komunën e Prizrenit dhe do të përkrahet zbatimi i programeve për aftësim profesional përmes alokimit të fondeve të veçanta për këtë qëllim.

Analiza e nevojave të tregut adekuat dhe të fuqisë punëtore lidhur me mundësinë e shtimit të numrit të punësuarave nga radhët e PAK është masë e paraparë, e cila do të ofrojë informata të nevojshme në mënyrë që të krijohen mundësi punësimi për PAK në komunën e Prizrenit. Kjo masë do të nxisë një cikël veprimesh institucionale sikurse që janë planifikuar: angazhimi i konsulentës për hulumtim të tregut dhe të fuqisë punëtore adekuate për PAK, hartimi i një oferte të fuqisë punëtore nga radhët e PAK. Rezultatet e hulumtimit do të prezantohet në publik dhe do ti shpërndahet të gjitha subjekteve afariste në Komunën e Prizrenit.

Ofrimi i mundësive për përfshirje në punësim të PAK do të mundësohet duke ofruar lehtësime nga komuna për nisje të bizneseve të reja nga PAK. Komuna duke ofruar hapësirat e veta me qira simbolike, duke e zbritur taksën komunale për bizneset e reja që hapen nga PAK, duke ofruar komuna hapësira të saja për të ushtruar veprimtari artizanale, turistike dhe të trashëgimisë kulturore për PAK.

Një masë e identifikuar në këtë dokument strategjik si mundësi që bizneset (komerciale) të stimulohen për të shtuar numrin e punëtorëve nga radhët e PAK, do të ishte që në shprehje të interesit / tenderëve komuna të rekomandojë / inkurajojë përfshirje më të madhe të punëtorëve nga radhët e PAK.

Shtrirja e shërbimeve në komunitet si masë e radhës së objektives së tretë të këtij dokumenti strategjik, do të zbatohet përmes funksionalizimit më të mirë të qendrave për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar dhe përmes dhënies së granteve për zhvillim të shërbimeve për këtë kategori. Ofrimi i trajnimeve për ekspertët të këtyre qendrave do të mundësoj ofrimin e shërbimeve më kualitative dhe të bazuara në nevoja të FNV dhe PAK.

Duke dashur që PAK të jenë ndërgjegjësuar për shfrytëzimin e skemës sociale dhe të kenë informacione të mjaftueshme për shërbimet që i ofron qendra sociale, do të ndërmerren veprimet e vazhdueshme informuese për të drejtat e shfrytëzimit të skemës sociale.

**Objektiva e katërt ”Krijimi i kushteve të barabarta në qasje për PAK”**

Kjo objektivë synon t’i kontribuojë krijimit të kushteve dhe mundësive të barabarta në qasje të personave me aftësi të kufizuar në komunën e Prizrenit.

Për ta mundësuar arritjen e kësaj objektive të këtij dokumenti strategjik janë planifikuar një sërë masash të përcjella me veprime konkrete. Hulumtimi sipas nevojës për gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për PAK, është një masë e cila do të ngritë një mori veprimesh të organizuara institucionale. Zhvillimi i hulumtimeve në nivelin lokal për qasje për PAK, fushata vetëdijesuese për

rëndësinë e qasjes së PAK në objektet publike, përfshirë sektorin privat, hulumtimi dhe përmirësimi i qasjes në institucione shëndetësore për PAK, hulumtimi për qasjen e institucioneve shëndetësore të përshtatshme për PAK, fushata vetëdijesuese për rëndësinë e qasjes së PAK në ofruesit e shërbimeve shëndetësore, ndërtimi dhe funksionalizimi i rampave për qasje (me pjerrësi max 6% sipas standardëve E.C), dhe tualeteve me standarde për PAK në objektet shëndetësore publike, janë identifikuar si veprime të nevojshme për të krijuar mundësi të duhura për rritjen e qasjes së PAK.

Sigurimi i qasjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit është masë e planifikuar mirë, realizimi i së cilës do të mundësohet duke përmirësuar dhe përshtatur infrastrukturën shkollore për PAK, ndërtuar dhe funksionalizuar rampat për qasje (me pjerrësi max 6% sipas standardëve E.C), dhe tualeteve me standarde për PAK në objektet e arsimit të komunës së Prizrenit.

Sigurimi i qasjes dhe informacionit në transportin publik, do ta mundësojnë veprimet e planifikuara, duke e përshtatur infrastrukturën në stacionet e transportit publik, pajis mjetet e transportit publik me pjerrina, sinjalet tonike dhe vizuale.

Krijimi i mundësive për përfshirjen e PAK në jetën kulturore do të mund të realizohet duke mundësuar organizimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar mbështetje financiare të projekteve nga aktivitetet kulturor-artistike dhe sportive për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke përfshirë të rinjtë nga radhët e PAK në aktivitetet rinore dhe duke siguruar mbështetje për bashkëpunimit regjional për PAK.

**Objektiva e pestë ” Krijimi i kushteve të barabarta në qasjen e jetës publike për PAK ”**

Qëllimi i kësaj objektive është që të siguroj të drejtën e PAK në informim të drejtë dhe të shpejtë, komunikim efektiv dhe mundësi për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike. Kjo gjë do të mundësohet me zbatimin e masave të parapara në këtë dokument strategjik si në vijim: Hartohet lista e verifikimit për promovimin e PAK në nivel komune, është shtuar shkëmbimi i informacionit mes organizatave të ShC, të PAK dhe organeve gjegjëse komunale përmes organizimit të takimeve të rregullta koordinuese dhe informuese me ZDNj, OShC dhe PAK.

Duke dashur që ta sigurojë gjithëpërfshirjen, Komuna ofron mundësi për pjesëmarrje gjatë procesit të buxhetimit përmes organizimit të takimeve publike lidhur me buxhetin në vendbanimet ndërurbane, urbane dhe rurale, shqyrtimit të propozimeve të pranuara nga takimet publike, nga grupet e interesit të PAK, të bëhen publike propozimet për buxhet që vijnë nga grupet e interesit të PAK.

Masë e rëndësishme e cila siguron organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese komunale për çështjet që lidhen me AK, është përkrahja e mjaftueshme financiare e siguruar nga komuna për PAK, duke identifikuar çështjet/fushat që kanë nevojë për ndërgjegjësim dhe përkrahë aktivitetet ndërgjegjësuese për çështjet gjinore.

Rritja e pjesëmarrjes së PAK në nivel të dëshiruar në jetën publike është masë shumë e nevojshme, e cila do të mbështetet në organizimet për fushata ndërgjegjësuese për të ftuar PAK në jetën publike.

Grupet e këshilltarëve të asamblesë komunale do ti konsultojnë grupet joformale dhe formale të PAK. Kjo do të zbatohet duke organizuar takime të rregullta të grupeve parlamentare me përfaqësues të PAK nëpër vendbanime.

Prioritizimi i rezultateve të argumentuara mirë nga aktivitetet avokuese të OShC të PAK, është masë e cila do të mbështetet në veprimet e ZDNj, e cila i paraqet prioritetet në takimet e rregullta të këshilltarëve të kryetarit të komunës së Prizrenit.

